

[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

# bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, i përmuajshëm, Nr. 4, shtator 2017

## Shëngjini, 1 milionë turistë në sezonin 2017

Proposed partner municipalities



No.	Municipality	Score (100 max)
1.	Shkoder	75
2.	Lezha	70
3.	Elbasani	65
4.	Durrës	64
5.	Permeti	54
6.	Korça	50
7.	Librahidi	48
8.	Tropoja	48
9.	Tirana	46
10.	Risikovc	45



Lezha, partnere e Programit ReLOaD, fq 4

Bashkia mirëpret vitin e ri shkollor, fq 6

Hapet Bulevardi "Faik Konica", fq 12


"Lezha feston", atmosferë ndryshe, fq 14





**Redaksia**

Drejtoria e Integritimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit  
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri  
Fotot: Olsi Tetaj  
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj  
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli  
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



**përmbajtja**

Lezha, bashki partnere e Programit ReLOaD	4
Bashkia Lezhë mirëpret vitin e ri shkollor	6
Përkujtohet At Zef Pllumi	8
Ministrja e Kulturës në Lezhë	9
Situata me Emergjencat e zjarreve	10
Zgjidhet problemi i varrezave publike në Lezhë	12
Hapet plotësisht Bulevardi "Faik Konica"	12
Frrokaj uron për festën e Kurban Bajramit	13
Shpërndahen mjete shkollore për fëmijët	13
"Lezha feston", një atmosferë ndryshe	14
Shëngjini, 1 milion turistë	15
Memoriali i Skënderbeut, destinacioni kryesor	16
Nis bashkëpunimi me Sisako- Mosllavinën	17
Lezhë, zyrë avokatie falas	18
Plazhi i Tales, një destinacion i ri në Lezhë	19
Fillon në Lezhë viti i ri mësimor 2017-2018	20
Arsimi profesional në Lezhë në rritje	21



# Lezha përzgjidhet si bashki partnere e Programit ReLOaD

Më 15 shtator 2017, në Bashkinë Lezhë pati një vizitë pune nga përfaqësuesja e zyrës së UNDP-së Shqipëri, Zj Entela Lako së bashku me drejtuesen e programit ReLOaD për Shqipërinë, Zj. Eglantina Gollaj, të cilat u pritën nga Kryetari i Bashkisë Z.Fran Frrokaj. Zj. Lako përgëzoi punën e bërë nga Bashkia Lezhë për bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile, gjë që ishte një nga kriteret kryesore për zgjedhjen e bashkisë tonë si partnere e projektit Reload. Nga 61 Bashki, vetëm 35 shprehën interes për

këtë program, nga të cilat vetëm 12 janë kualifikuar dhe do përfitojnë grante. Bashkia Shkodër dhe Lezhë kryesojnë listën e 12 Bashkive fituese duke u vlerësuar si dy Bashkitë që plotësojnë më së miri kriteret e performancës dhe përfshirjes në projekt si: 1.Bashkia ka bashkëpunim të vazhdueshëm dhe praktika të mira me OSHC-të; 2.Bashkia ka një plan të miratuar të zhvillimit të komunitetit ose çdo dokument strategjik ku identifikohen prioritetet e zhvillimit socio-ekonomik; 3.Bashkia ka mekanizma për monitorimin /

## Proposed partner municipalities



No.	Municipality	Score (100 max)
1.	Shkoder	75
2.	Lezha	70
3.	Elbasani	65
4.	Durres	64
5.	Permeti	59
6.	Korca	54
7.	Librazhdi	50
8.	Tropoja	48
9.	Tirana	46
10.	Roskovec	45

vlerësimin e projekteve dhe iniciativave të zbatuara nga OSHC-të.

Në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale (ReLOaD), financuar nga Bashkimi Europian, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (UNDP) zgjodhi sot partnerët e tij që do jenë 12 Bashki në Shqipëri. (Shkodër, Lezhë, Elbasan, Durrës, Përmet, Korçë, Librazhd, Tropojë, Tiranë, Roskovec, Dibër dhe Prrenjas). Bashkitë do të përfitojnë nga skema e granteve të Programit. Skema pritet të mbështesë organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që ofrojnë shërbime publike në përputhje me prioritetet e ngritura nga Bashkia e dhënë dhe mbështesin synimin e Programit për zhvillimin, ose përmirësimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të brenda bashkive partnere.

Bashkitë do të ngrenë grupe pune të mirëfillta për të realizuar dhënien e granteve të qeverisjes vendore për organizatat e shoqërisë civile, praktikë

kjo që realizohet për herë të parë në Shqipëri, sipas skemës së provuar më parë si të suksesshme në Bosnjë dhe Hercegovinë. Projekti ReLOaD do të ngrëjë në Lezhë një fond prej 125 000 euro të bashkëfinancuara nga Bashkimi Europian dhe Bashkia Lezhë të cilat do të jenë të shfrytëzueshme nga organizatat e shoqërisë civile aktive në Lezhë në bazë të një skeme me 5 thirrje të ndryshme për projekte. Bashkitë partnere do të mbështeten nga projekti gjatë zbatimit të skemës së granteve.



# Bashkia Lezhë mirëpret vitin e ri shkollor

Ndërhyrjet që janë bërë në institucionet arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor!

Bashkia e Lezhës mori një sërë masash për vitin e ri shkollor 2017-2018. Për t'i paraprirë krijimit të kushteve sa më të përshtatshme gjatë muajve Korrik dhe Gusht u hartua një plan pune duke marrë në analizë situatën e çdo institucioni arsimor, përfshirë çerdhet, kopshtet, shkollat dhe konviktin e shkollës profesionale "Kolin Gjoka". Në çdo institucion arsimor Bashkia Lezhë ka kryer shërbimin DDD (dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin), punimet hidrosanitare si dhe janë furnizuar më bazën e duhur materiale higjeno-sanitare.

Konkretisht është ndërhyrë si më poshtë:



## NJËSIA ADMINISTRATIVE LEZHË ( QYTET):

**Gjimnazi "Hydajet Lezha":** Janë lyster koridoret si dhe klasa e informatikës. Është bërë perçinosja e karrikeve, stolave dhe tavolinave.

**Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja":** Është lyster fasada e shkollës.

Është bërë perçinosja e karrikeve dhe tavolinave. Janë vendosur kangjella në të gjitha dritaret e katit të parë. Janë zëvendësuar xhamat e thyer.

**Shkolla 9-vjeçare "Gjergj Kastrioti":** Është lyster fasada e shkollës.

Janë kryer stukime dhe lyster të korridoreve. Është bërë perçinosja e karrikeve dhe tavolinave.

**Shkolla 9-vjeçare "Gjergj Fishta"**

Është bërë perçinosja e karrikeve dhe tavolinave.

**Shkolla 9-vjeçare "Kosova":** Janë lyster koridoret dhe dy grupet e kopshtit "Skënderbeg". Është bërë perçinosja e karrikeve dhe tavolinave.

**Kopshti "Gurra":** Janë kryer stukime dhe lyster të grupeve.

**Çerdhja e qytetit:** Janë kryer stukime dhe lyster të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme. Janë lyster kangjellat.

# Ndërhyrjet e Sektorit të Shërbimeve për pritjen e vitit të ri shkollor

## NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN:

**Shkolla 9-vjeçare Spiten:** Janë kryer stukime dhe lyster të ambjenteve të brendshme dhe fasadës së shkollës. Është kryer hidroizolimi i tarracës. Janë kryer punime elektrike.

**Shkolla 9-vjeçare Pllanë:** Janë kryer punime elektrike.

**SHMB Zejmen:** Janë kryer punime elektrike.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH:

**Shkolla 9-vjeçare Manati:** Është kryer riparimi i tavaneve me gips. Janë lyster koridoret.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNKOLL:

**SHMB "Llesh Nik daka" Shënkoll:** Janë lyster koridoret, holli, fasada dhe disa klasa. Janë kryer punime elektrike

**Kopshti Shënkoll:** Janë kryer stukime dhe lyster të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme. Janë kryer punime elektrike.

**Shkolla 9-vjeçare Grykë Lumi**

Janë kryer stukime dhe lyster të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme. Janë kryer punime elektrike.

**Shkolla 9-vjeçare Rrilë:** Janë kryer punime elektrike.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN:

**Shkolla 9-vjeçare "At Zef Pllumi" Shëngjin:** Janë lyster ambjentet e brendshme dhe të jashtme. Janë zhbllokuar tualetet dhe pusetat e kontrollit.

**Shkolla 9-vjeçare Ishull Shëngjin**

Janë lyster ambjentet e brendshme të shkollës, stukime dhe suvatime.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE:

**Shkolla fillore Gocaj**

Janë lyster dy klasa

## NJËSIA ADMINISTRATIVE KALLMET:

**SHMB "Fank Bardhi" Kallmet**

Është zgjidhur problemi i furnizimit me ujë, duke shtrirë 600 m linjë nga ujësjellësi deri në shkollë.

**Shkolla 9-vjeçare Rraboshtë:** Janë zëvendësuar xhamat e thyer.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE BLINISHT:

**SHMB Blinisht:** Është kryer lysterja e korridoreve.

## NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ:

**SHMB "Gjovalin Gjadri" Gjadër**

Është vendosur pompa e ujit. Janë kryer punime elektrike.





# Bashkia Lezhë përkujton 10-vjetorin e ndarjes nga jeta të At Zef Pllumit

Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Bibliotekën publike të qytetit kanë organizuar një takim përkujtimor në nderim të figurës së At Zef Pllumit, me rastin e 10-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta. Përmes kujtimeve nga leximi i veprës monumentale "Rrno për me tregue" u synua sjellja në kujtesë e profilit dhe kontributeve të tij. At Zef Pllumi, pinjoll i një familjeje të njohur malësore nga Mali i Rrencit në Shëngjin të Lezhës, qysh në moshën 5-vjeçare, në vitin 1929, u bë nxënës i Alfons Trackit, misionarit gjerman në Velipojë të Shkodrës. Kryetari i Bashkisë Lezhë, Fran Frrokaj e vlerësoi At Zef Pllumin "si përfaqësues të pasurisë kulturore e njerëzore, si një institucion të vërtetë, klerik i denjë që i rezistoi regjimeve dhe kohërave më të vështira dhe si simbol i qytetarit të lirë, vizioni i të cilit frymëzohet nga vlerat europiane". Gjithashtu personalitete vendore, klerikë, studiues, shkrimtarë, pjesëtare e të afërm të familjes folën gjerësisht për At Zef Pllumin si një nga figurat e qëndrues nën diktaturë dhe mendimit të përparuar shqip. Një varg aktivitete përkujtimore, shkencore e promovuese, po organizohen në Lezhë, në nder të kësaj figure të ndritur që gjatë gjithë jetës së vet dëshmoi e nuk rreshti së besuari te Zoti e te liria. "Unë tanë jeten e kam kaluar në burg, por mendimtar i lir. Ta mendojmë vedin zogj të lirë e fluturojmë ku të duem..." – Kjo ishte dëshira, por edhe porosia e madhe e At Zef Pllumit për popullin e vet, dashuria për të cilin e çoi në sakrificat e pashembullta.



# Ministrja e kulturës në Lezhë, përgëzon bibliotekën dhe njihet me problematikat e Memorialit

Ministrja e Kulturës ka vlerësuar si një ndër më të mirat në vend Bibliotekën Publike të Lezhës, e cila vijon të shërbejë si model edhe për qytetet e tjera. Ndërsa prej javës tjetër nisim turin e ri të Bibliotekës shëtitëse në të gjitha shkollat e zonës rurale në Lezhë, kampionët e leximit për vitin e shkuar akademik, u përgëzuan në Bibliotekën e Lezhës nga Ministrja e Kulturës Znj. Kumbaro. Ish nxënësit e mësues Arbenit, këtë vit, në klasë të 6-të në shkollën e Blinishtit, zbukuruan këtë festë të librit, ndërsa ministrja e Kulturës shpalli nga Biblioteka e Lezhës projektin e ri kombëtar "Për ri-jetësimin e Bibliotekave vendore", i cili mbështet këto institucione duke i pasuruar me rreth 80 tituj të rinj. Biblioteka shëtitëse e Lezhës, mbetet një shembull i mirë dhe i vetmi në vend, duke qenë të gjithë bashkë me dëshirën e madhe që të nxisim leximin tek të vegjëlit dhe të rinjtë, si investimi më me vlerë për të ardhmen. Ne jemi shumë qe e duam librin. Më pas, Ministrja Kumbaro e shoqëruar nga zyrtarë të Bashkisë dhe përgjegjës të DRKK Shkodër, vizitoi Me-



morialin e Skënderbeut ku u njoh me problematikat kryesore si dhe nevojën për ndërhyrje në këtë objekt të rëndësisë së veçantë kombëtare. Zonja Kumbaro e cila u njoh me situatën e cila është problematike më së shumti sa i takon gjendjes infrastrukturore të Memorialit, u zotua për bashkëpunim për të ndryshuar gjendjen në një kohë kur viti 2018 është shpallur si vit jubilar për Heroin tonë Kombëtar.

Bashkia Lezhë i paraqiti tre kërkesa ministres së Kulturës znj. Mirela Kumbaro që në kuadër të vitit të Gjergj Kastriot- Skënderbeut, të jetësohen sa më parë në mënyrë që figura e Heroit tonë Kombëtar të vlerësohet ashtu siç i takon.

Tre kërkesat e paraqitura nga Bashkia Lezhë janë:

1. Shpalljen e datës 2 Mars, Festë Kombëtare;
2. Vendosi e bustit të Gjergj Kastriot- Skënderbeut në sheshin që mban po të njëjtin emër në qendër të qytetit të Lezhës;
3. Investimin për rikualifikimin e Memorialit të Heroit tonë Kombëtar.





# Emergjencat e zjarreve përballohen nga të gjithë, bashkë

Emergjencat Civile dhe Menaxhimi i Krizave  
Situatat emergjente për muajin Gusht 2017.

Gjatë muajit gusht në territorin e Bashkisë Lezhë kemi patur problematika të mëdha me fenomenet e rënies së zjarreve, vatrat e të cilave kanë përfshirë sipërfaqe të konsiderueshme me pyje, shkurre, ferra dhe kullota, të shtrira në terrene fushore, kodrinore dhe malore. Vatrat e zjarreve kanë qënë në 59 raste, ku veçojmë:

- dy raste në objekte magazinë familjare, ku ka patur vetëm djegie materiale pa dëme njerëzore, si në Tresh dhe Kodër Marlekaj;
- pesë raste ku janë djegur sipërfaqe të mëdha me pyje pishe, shkoze, lisi, ahu në malin Grykë-Manati, në malin e Shëngjinit dhe Berzanës, në malin e Rrencit (Malecaj) dhe në Tale, ku për shuarjen e tyre, në pamundësi për përballimin e situatave të krijuara me forcat e mjetet që disponon Bashkia Lezhë, kemi kërkuar nëpërmjet institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë ndihmë për mbështetje me forca e mjete zjarfikëse nga të cilat janë dërguar gjithsej 80 forca aktive ushtarake, si dhe 4 mjete zjarfikëse nga Ministria e Mbrojtjes, ndërsa në malin e Berzanës, në operacionin e shuarjes së zjarrit ka marrë pjesë dhe një helikopter i kompanisë Viva Copter, i cili ka hedhur ujë nga ajri në vatrën e zjarrit për 2h:45min.
- Vatrat e tjera të zjarreve kanë qënë në sipërfaqe në shkurre, ferra, barishte dhe kullota.

Në operacionet e shuarjes së zjarreve, janë angazhuar forcat dhe mjetet që disponon vetë Bashkia si, Shërbimi i MZSH-së, Drejtoria e Emergjencave Civile, Agjensia e Shërbimit të Pyjeve, punonjësit e Njësive

Administrative (sipas rastit), në raste të veçanta edhe banorët në komunitet, si dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve, Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (siç është rasti në malin e Berzanës).

Ka pasur bashkëpunime të rregullta me Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, zyrën e Emergjencave Civile. Gjithashtu në këto operacione sikurse thuhet e më lart, kanë marrë pjesë forcat e Ushtrisë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në mbështetjen dhe zgjidhjen e këtyre operacioneve. Pavarësisht masave të marra dhe punës së bërë nga të gjitha drejtoritë dhe institucionet pjesëmarrëse me forca e mjete në operacionet e shuarjes së zjarreve, dëmi i shkaktuar në këto zjarre është i konsiderueshëm dhe me pasoja të mëdha ekologjike, duke u bërë shkak për një zhdukje të konsiderueshme të bimësisë, të disa insekteve të dobishme apo edhe të ndotjes së ambjentit. Ka humbje të mëdha të sipërfaqeve të gjelbërta, dëme ekonomike me kosto të mëdha financiare të cilat duhen vite për t'u rikuperuar e për t'ju rikthyer gjendjes së mëparshme. Ndërhyrjet kanë qënë të domosdoshme për të normalizuar situatat emergjente të krijuara. Angazhimet e të gjitha forcave dhe mjeteve që kanë marrë pjesë në operacionet e shuarjes së zjarreve nuk kanë qënë të vogla. Në shumicën e rasteve zjarret kanë rezultuar të qëllimshëm, duke pasur si qëllim dëmtimin e ekonomisë në funksion të privatësisë për hapjen e kullotave, shesheve të ndërtimit apo lehtësimin të lëvizjeve të njerëzve e gjësë së gjallë në shpatet e maleve me pyje, pa marrë parasysh pasojat e dëmet që ato sjellin. Në operacionet e shuarjes

së zjarreve, veç të tjerave, janë shpëtuar jetë njerëzish si dhe shumë banesa të cilat u mbrojtën me profesionalizëm nga forcat pjesëmarrëse dhe në veçanti nga shërbimi i MZSH-së, të cilët bënë të mundur që këto banesa të mos përfshiheshin nga flakët e zjarrit vdekjeprurës. Puna e mire që është bërë deri tani, duke evituar pasojat shumë më të mëdha nga ato që kanë ndodhur, e ka burimin tek forca dhe guximi në grup për përballimin e situatave emergjente. Për këtë qëllim, disa muaj më parë është hartuar një plan veprimi (masash) midis drejtorive dhe institucioneve që marrin pjesë në parandalimin dhe përballimin e situatave të tilla, e në veçanti mbrojtjen nga zjarret për periudhën e verës dhe dhënien e përgjigjes ndaj këtyre situatave në kohë, sepse kur njoftimi për fenomenin e ndodhur është i vonuar (nuk bëhet në kohën dhe në vendin e duhur) atëherë shërbimet tona nuk mund të jenë shumë efikase, sikundër ka ndodhur me zjarrit e rënë në malin e Berzanës ku njoftimi është bërë atëherë kur vatra e zjarrit kishte dalë jashtë kontrollit dhe për shuarjen e saj u deshën disa dite. Në këndvështrimin tonë, në funksion të përmirësimit të punës, forcimit të gatishmërisë të të gjitha forcave e mjeteve që kemi në dispozicion për parandalimin dhe zgjidhjen e situatave emergjente me sa më pak humbje, është e nevojshme së pari vetëdërgjegjësimi i çdo anëtari në komunitetin tonë dhe i atyre që kanë detyrimin ligjor të drejtpërdrejtë, për të njoftuar menjëherë për çdo rënie zjarri, fenomene natyre, dhe jo më pak për ato dëme që vijnë si pasojë e veprimtarive njerëzore. Për të siguruar njoftimin, janë vënë në dispozicion numrat telefonikë falas si 112, 128 dhe 129. Vetëm duke vepruar kështu do të kuptohet më mirë nga të gjithë se pasuria kombëtare është e të gjithëve dhe si e tillë duhet të mbrohet e mirëmbahet. Situata emergjente nga faktorë natyrorë mund t'u ndodhin të gjithëve, reagimi për përballimin e saj duhet të jetë i përbashkët.





## Zgjidhet problemi i varrezave publike në Lezhë

Bashkia Lezhë i ka dhënë zgjidhje problemit të varrezave, të cilat mendohet t'u shërbejnë qytetarëve të Lezhës për rreth 50 vitet e ardhshme. Zgjidhja e gjetur është prezantuar gjatë një dëgjese publike me qytetarët. Për kreun e Bashkisë Lezhë, Z.Fran Frrokaj, kjo zgjidhje vjen në një kohë kur situata është përkeqësuar ndjeshëm, ndërsa ka shtuar se ato do të përmbushin gjithë kriteret për një shërbim të tillë. Kjo marrëveshje vjen në një kohë që ne e kishim të domosdoshme sigurimin e një vendi tjetër për varreza, pasi e dimë shumë mirë që Lezha në varrezat ekzistuese ka vetëm 20 vende varrimi dhe çdo hapësirë tjetër është në kufijtë e ngopjes. Është një popullsi pothuajse e dy- tre fishuar në 20 vitet e fundit, ndaj, rrethi i Lezhës ka nevojë për këtë ambient për të ndërjet që ndërrojnë jetë", është shprehur Z.Fran Frrokaj. Drejtori i Shërbimeve Publike në Bashkinë Lezhë, Ndue Lushi, prezantoi kriteret ligjore dhe teknike që do të përmbushen, duke theksuar se janë më të mirat që mund të ketë një varrezë publike në të gjithë Shqipërinë. Për një periudhë prej 50 vitesh kjo varrezë mund të plotësojë nevojat e këtij shërbimi gjithnjë në proporcion me rritjen e popullsisë së Lezhës.



## Hapet plotësisht Bulevardi "Faik Konica"

Një banesë qëndronte si pengesë me rrezikshmëri levizjeje në mesin e Bulevardit "Faik Konica", e cila u ndërtua para disa vitesh si pjesë e sistemimit të bllokut 11.2 ha në lagjen "Besëlidhja". Për shkak të këtij objekti, një nyje e rëndësishme për shfryrjen e trafikut kishte dalë thuajse jashtë funksionit. Bashkisë Lezhë i janë dashur 12 ore për të zgjidhur një problem disa vjeçar. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor në Lezhë ndërhyri për prishjen e ndërtesës dy katëshe. Pronarët larguan në mënyrë vullnetare pajisjet dhe orenditë e tyre, ndërsa aksioni u mbështet edhe nga policia e rendit. Drejtori i Shërbimeve Publike në Bashkinë Lezhë, Ndue Lushi, tha se ndërhyrja ishte e domosdoshme. Edhe largimi i inerteve u bë menjëherë duke mos humbur kohë për të sistemuar këtë segment rrugor. Në mbrëmje, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërhyri për të bërë asfaltimin dhe sistemimin e trotuarit. Në mesnatë gjithçka ishte gati dhe aksi që lidh rrugën "Luigj Gurakuqi" me bulevardin "Papa Gjona Pali II", rrugën "Shtraus" dhe rrugën e re të spitalit u bë më në fund lehtësisht i kalueshëm. Puna po vazhdon për të përmirësuar të gjitha veprat e artit lidhur me këtë segment, si trotualet, ndriçimi apo veshja e mureve anësore me pllaka dekorative, dhe pas disa ditësh e gjitha do të jetë e përfunduar.



## Frrokaj uron për festën e Kurban Bajramit

Komuniteti musliman i Lezhës ka festuar Kurban Bajramin. Myftia Agim Tereziu, ka pritur në xhaminë e qytetit autoritete të kishës katolike, pushtetit lokal dhe partive politike, të cilët i falenderoi për vizitën, duke theksuar se Kurban Bajrami është simbol i sakrificës, sinqeritetit dhe devotshmërisë që besimtari duhet të ketë për krijuesin e gjithësisë. Ndaj, vijoi Tereziu, Kurban Bajrami na afron më afër Zotit dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë ditë të begatë dhe të jemi më pranë njerëzve në nevojë. Kreu i Bashkisë së Lezhës, Z.Fran Frrokaj, ka qënë ndër të parët që ka vizituar dhe uruar komunitetin musliman të Lezhës për festën e Kurban Bajramit. Z.Frrokaj theksoi se, dua të uroj gjithë besimtarët musliman të Lezhës që kjo ditë ripërtëritje besimi të shërbejë për të çliruar shpirtat nga brengat dhe vështirësitë e përditshme, e t'u japë më shumë forcë e shpresë për të ardhmen, paqe, mirëqenie, harmoni dhe mbi të gjitha dashuri për njeri-tjetrin. Më pas, Kreu i Bashkisë, Z.Frrokaj ka festuar me fëmijët e Qendrës Kulturore "Gjergj Laca" Lezhë, të cilët për festën e Kurban Bajramit kishin përgatitur enkas një koncert me këngë, valle e muzikë orkestrale me instrumente popullore të traditës.



## Shpërndahen mjete shkollore për fëmijët në nevojë

Bashkia Lezhë bashkëpunon me organizatën "Terre des homes", përkatësisht mbi mbështetjen e familjeve të rikthyera nga emigracioni duke i mbështetur ato për t'i riintegruar në familje dhe shoqëri. Ky projekt zgjeroi target grupin e përfituesve, dhe për fillimin e vitit të ri shkollor bëri të mundur që fëmijët e familjeve në nevojë të ishin gjithashtu përfitues të këtij projekti. Shumë familje duke qënë se jetojnë në kushte shumë të vështira social- ekonomike e kishin të pamundur pajisjen me çanta dhe mjete didaktike për fëmijët e tyre. Kështu, në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor, sektori i Kujdesit Social pranë Bashkisë Lezhë, së bashku me organizatën "Terre des Hommes", mundësuan çanta dhe mjete shkollore për 40 fëmijë të qytetit të Lezhës dhe të Njesive Administrative. Fëmijët që u përfshinë në këtë projekt ishin të përzgjedhur si fëmijë të familjeve më të varfëra, dhe duke marrë parasysh gjendjen e tyre të vështirë ekonomike ishte e domosdoshme që të ishin pjesë e këtij projekti. Fëmijët që përfituan ishin të moshave të ndryshme, duke filluar që nga klasa e parë deri në shkollë të mesme. Kjo mbështetje solli motivim për secilin nxënës për të filluar sa më mirë këtë vit të ri shkollor.





# Lezha feston, një atmosferë ndryshe

Bashkia Lezhë solli këtë verë për të gjithë qytetarët, emigrantët, vizitorët e turistët aktivitetin “Lezha Feston”. Ky aktivitet u zhvillua në sheshin “Gjergj Kastrioti” nga data 5 gusht deri më 20 gusht. Festa përfshinte aktivitete artistike e kulturore, ndërsa në shesh u vendosën bizneset lezhjane të shërbimit, duke krijuar një atmosferë argëtuese për të pranishmit. Bashkia e Lezhës u krijoi një mundësi më shumë bizneseve për tu promovuar, ndërsa i dha një tjetër këndvështrim jetës së natës në këtë qytet. Projekti “Lezha Feston” që organizohet për të dytin vit radhazi, ishte një aktivitet i zgjatur në kohë duke synuar që të promovojë artin, kulturën dhe turizmin në Lezhë. Këto dite festive, e kulmuar me organizimin e Ditës së Shtegtarit më 15 gusht, ishin një mundësi më shumë për zhvendosjen e pushuesve dhe turistëve nga bregdeti drejt Lezhës duke krijuar alternativa më shumë për argëtimin e tyre. “Lezha Feston” u konceptua dhe u realizua në sheshin administrativ të

qytetit për dy javë me radhë, ndërsa bizneset e shërbimit krijuan një atmosferë të këndshme. Për të patur mbremje sa më interesante për të pranishmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës e Sportit u angazhua për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që do ti jepnin tjetër ritëm mbremjes. Menaxhimi i aktivitetit u realizua në bashkëpunim me bizneset pjesëmarrëse ndërsa pjesë e tij u bënë artistë të ndryshëm që performuan në skenën e realizuar për këtë qëllim, ndërsa ritmin e mbremjes e krijuan DJ të ndryshëm që morën pjesë çdo natë në shesh. Gara e birrës me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të krijuara në çast, mundja e krahut dhe goditje me shigjeta, ishin një tjetër

formë argëtuese për të pranishmit që e kanë vlersuar maksimalisht këtë organizim. “Lezha Feston” u monitorua nga Policia Bashkiake, policia private dhe ajo e rendit pavarësisht se nuk u shoqërua me incidente. Pjesëmarrja në këtë aktivitet përgjatë dy javëve ishte shumë e lartë duke përmbushur pritshmëritë dhe duke siguruar edhe vazhdimësinë e saj në të ardhmen. Aktiviteti pati si kulm të saj 15 gushtin, Ditën e Shtegtarëve, një festë që nisi rreth orës 19:00 dhe vijoi deri pas mesnatës. Në skenën e madhe të vendosur në shesh u ngjiten emra të njohur të muzikës lezhjane dhe asaj shqipëtare, ndërsa është ndjekur nga një numër i madh i të pranishmëve. Panairi me produkte të zonës ishte një tjetër mundësi e krijuar për larminë e këtij aktiviteti, ndërsa vlerësimi me çertifikatë i nxënësve të ekselencës apo sportistëve medalistë në sporte të ndryshme ishte vlerësimi i Bashkisë Lezhë për arritjet e tyre.



# Shëngjini, 1 milion turistë

Po të fillosh të flasësh për bukuritë e bregdetit të Shëngjinit, nuk do të mjaftonin fjalët. E vetmja gjë që mund të bësh është ta vizitosh e të ngelesh i mahnitur. Shëngjini konsiderohet si perla e bregdetit të Adriatikut. Bregdeti i Shëngjinit ka qënë një ndër destinacionet më të frekuentuara të këtij sezoni turistik duke shënuar një dyndje të numrit të turistëve. Këtë vit turistët që e kanë vizituar Shëngjinin kanë qënë nga Çekia, Sllovakia, Polonia, Gjermania. Ndryshe nga herët e tjera ka pasur turistë përtej oqeanit nga Zelanda e Re, Kili nga Amerika e Jugut, Indonezia, Japonia. Investimet e shumta kanë bërë që numri i turistëve të rritet akoma edhe më shumë duke shkuar kështu në një milion pushues nga ku gjysma kanë qënë turistë dhe vizitor. Pushuesit janë shprehur mjaft të kënaqur me shërbimet që u janë ofruar dhe me ambjentin. Ndër të tjera, ato janë shprehur se çdo vit ka përmirësime, dhe që Shëngjini do të vazhdojë të jetë një ndër destinacionet e tyre të preferuara. Pastërtia e ujit, e rërës, siguria, rritja e standartit të shërbimeve dhe gjallëria në këtë qytet bregdetar, kanë qënë disa nga arsytet që Shëngjini të pëlqehet e të preferohet shumë si vend për të kaluar pushime të paharrueshme gjë e cila po e bën konkures edhe me rivieren .Ndryshe nga vitet e tjera, në këtë sezon turistik ka pasur ujë dhe drita pothuajse 24 orë, gjë e cila ju ka krijuar lehtësim tek pushimet e tyre. Për cdo person i cili ka qënë i interesuar për të marrë informacione për pikat turistike me destinacion Lezhën , është vënë në dispozicion një numër kontakti nga zyra e turizmit në Bashkinë Lezhë, që ka qënë në dispozicion 24 orë. Përpos kësaj, gjithashtu është vendosur në qendër të qytetit të Shëngjinit zyra e informimit të turistëve ku aty turistët kanë gjetur edhe materiale infor-

mative-promovuese. Jeta e natës ka qënë një ndër pjesët më të preferuara të pushimeve sidomos tek të rinjtë, të cilët kanë shijuar muzikën live nga këngëtarë të famshëm shqipëtarë e të huaj, si dhe muzikë nga DJ mjaft të njohur të estradës deri në orë të vona të natës. Ndërsa ato që kanë synuar për qetësi e relaks, kanë gjetur vendin ideal që është kryesisht bregdeti i Kunes. Gjatë sezonit turistik bregdeti i Shëngjinit ka qënë në monitorim të vazhdueshëm për identifikimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre të menjëhershme. Një ndër kërkesat që shprehën pushuesit , ishte që të kishte më shumë hapësira publike po kjo nuk e ndaloi që të kishte një numër të lartë pushuesish. Gjithashtu janë vendosur në funksion kullat e vrojtimit të cilat kanë shërbyer për t’u ardhur në ndihmë të gjithë pushuesve të cilët kanë pasur probleme gjatë notimit në plazh dhe si rezultat i kësaj nuk ka pasur asnjë të mbytur. Këtë vit është përmirësuar infrastruktura për të shkuar tek Rana e Hedhur, ku është tërhequr mjaft vëmendja e turistëve për të bërë plazh si dhe për ta vizituar atë si një atraksion natyror. Aktiviteti argëtues “rrëshqitje në ranën e hedhun” ka tërhequr qindra pushues për ta ndjekur e për të qënë pjesë e tij. Madje kanë kërkuar që të zgjatej më shumë si aktivitet, si dhe të bëhej një i përvitshëm. Gatimet tradicionale dhe moderne ju janë sërviur pushuesve sipas kërkesave të tyre dhe ato kanë mbetur shumë të kënaqur si për shërbimin , ashtu edhe për cilësinë e gatimeve. Larmishmëria e kuzhinës në bregdetin e Shëngjinit i ka mahnitur shumë pushuesit e apasionuar ndaj artit të gatimit. Synohet shtimi i shërbimeve të tjera me akses në zonat e tjera turistike të Lezhës, si dhe promovimi i bregdetit të Shëngjinit përtej kufijve shqiptarë nëpërmjet mediave të huaja dhe portaleve të ndryshme në internet. Shëngjini mbetet vendi ideal për pushime relaksuese dhe argëtuese që mbeten gjatë në memorien e çdo pushuesi.



## Nis bashkëpunimi me Sisako- Mosllavinën



Një delegacion Kroat, që kryesohet nga Z.Ivo Zinic , Kryetar i Rajonit Sisako Mosllavina, po zhvillon një vizitë dy ditore në Lezhë. Gjatë ditës së sotme ata janë pritur nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, Z.Fran Frrokaj, i cili, pasi i falenderoi për interesin, shprehu gatishmërinë për të qënë bashkëpunues në disa fusha në zhvillim të forcimit të marrëdhënieve të mëtejshme me ndikim ekonomik, social dhe kulturor. Z.Ivo Zinic, i cili shoqërohej nga Zv.Kryetari i Rajonit, Z.Roman Rosavec, nga zëdhënësi i tij dhe nga drejtuesi i zhvillimit ekonomik të qytetit Kutina, Z.Hrvoje Krmelic, foli për marrëdhënie të shkëlqyera mes dy shteteve, ndërsa vlerësoi rolin e shqiptarëve në rajonin që kryeson, në të cilin jetojnë më shumë se një mijë shqiptarë. Kryebashkiaku Frrokaj, i cili në këtë takim mikpritës shoqërohej nga dy Zv.Kryetarët, Z.Enver Hafizi, Znj.Alfrida Marku si dhe nga Drejtori i Turizmit Z.Ardian Laçi, garantoj se njësia vendore që ai kryeson do krijojë të gjitha mundësitë për çdo investitor të huaj që shpreh interes për të financuar në fusha të ndryshme në Lezhë. Delegacioni Kroat më pas ka vizituar objekte të ndryshme të historisë dhe kulturës.

## Muzeu Historik, aktivitetet për periudhën Qershor - Gusht



Gjatë muajit Qershor 2017, në përfundimin e vitit shkollor 2016-2017 janë realizuar praktika mësimore dhe orë të veçanta mësimi me nxënës të shkollave të ndryshme të Shqipërisë dhe Kosovës lidhur me epokën e Gjergj Kastriot Skënderbeut. Gjatë muajit Qershor në Memorialin e Gjergj Kastriot Skënderbeut është realizuar një vizitë nga Nunci Apostolik Charles John Brown i shoqëruar nga Arqipeshkvi i Dioqezës Lezhë Mons.Ottavio Vitale. Më 28 Korrik 2017 është realizuar një simpozium shkencor nën drejtimin e përgjegjësit të Muzeut Z.Paulin Zefi me temë “Lezha, Mirdita ,Kurbini” lidhur me vlerat e trashëgimisë historike, kulturore dhe turistike në këto rajone. Më 15 Gusht 2017 në ditën e shtegtarëve, që është specifike vetëm për qytetin e Lezhës, hyrja në Memorialin e Skënderbeut ishte pa pagesë, për t’ju dhënë mundësinë të gjithë emigrantëve shqiptarë për t’u njohur me historinë e vendit të tyre duke pasur gjatë gjithë ditës në dispozicion guidat e Muzeut Historik.

## Memoriali i Skënderbeut, destinacioni kryesor në Lezhë

Gjatë muajit të gushtit ka patur një rritje të interesimit nga turistë vendas dhe të huaj. Vetëm gjatë kësaj periudhe ky aset i rëndësishëm historik pati vëmendjen e 1952 vizitorëve, prej të cilëve 1437 ishin persona të rritur, 253 nxënës e fëmijë dhe 262 të huaj. Më datë 15.08.2017, "Ditën e Shtegtarëve" hyrja ishte pa pagesë, kjo për t’ju mundësuar të gjithë emigrantëve dhe qytetarëve të Lezhës njohjen me historinë dhe rëndësinë e këtij monumenti me rëndësi historiko-kulturore me vlerë kombëtare. Pavarësisht mungesës së vëmendjes nga Ministria e Kulturës për rikonstruksionin e çatisë, rrethin apo vijimin e gërmimeve arkeologjike, memoriali i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot - Skënderbeu, vijon të mbetet një destinacion i rëndësishëm edhe i agjensive të ndryshme turistike edhe pse rrezikohet nga dëmtimi, për shkak se prej 3 vitesh është pa rrethim. Emergjente mbetet rrethimi dhe ndriçimi i memorialit, për të cilat janë përgatitur edhe projektet konkrete dhe janë dërguar për miratim pranë DRKK Shkodër dhe po punohet për gjetjen e donatorëve të mundshëm. Kjo i paraprin edhe përcaktimit nga Bashkia Lezhë të vitit 2018 si viti i Skënderbeut, në 550 vjetorin e kalimit në amshim të heroit, iniciativë e ndërmarrë gjatë kremtimeve të 2 Marsit, Besëlidhjes së Lezhës, deklaratë që e bëri Kreu i Bashkisë Z. Fran Frrokaj, e që mori edhe vëmendjen e mediave të ndryshme. Në këtë kuadër janë organizuar disa aktivitete të ndryshme, por kërkohet edhe mbështetja e Ministrisë së Kulturës. Përcaktimi për vitin 2018 si viti i Skënderbeut edhe nga ana e qeverisë vlerësohet si një ndikim pozitiv për shtimin e numrit të turistëve në këtë aset, por ky përcaktim duhet të shoqërohet edhe me alokim të fondeve për mirëmbajtjen e këtij objekti



dhe kremtimin e festave apo ngjarjeve që përkujtojnë heroin tonë kombëtar. Veçanti e këtij sezoni është fakti se vendvarrimi i Skënderbeut ka tërhequr vizitorë edhe nga përtej oqeanit. Pavarësisht se numri i tyre mbetet i ulët, interesimi i turistëve nga Zelanda e Re, Amerika, Japonia etj tregon mbi përmasat që ka ky aset historik. Turistët nga Hungaria e Austria tashmë e kanë kthyer në pikën e referimit të udhëtimit nëpër Shqipëri ndalimin në vendvarrimin e Skënderbeut. Memoriali i Vendvarrimit të Skënderbeut është një institucion i rëndësishëm kulturor, i cili ka një varësi të dyfishtë, nga Bashkia e qytetit Lezhë dhe Ministria e Kulturës. Përgatitjet për përkujtimin e 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit vazhdojnë nga ana e Bashkisë duke bashkëpunuar ngushtë edhe me institucione të tjera. Vendvarrimi i Skënderbeut, vendi ku në fakt u mbajt edhe Besëlidhja e Lezhës, është destinacioni kryesor i shqipëtarëve përtej kufinjëve të Shqipërisë, ndërsa është vendi ku më së shumti orientohen edhe ekspeditat e nxënësve të shkollave, studentëve dhe institucioneve të ndryshme.



# Lezhë, zyrë avokatie falas

Në qytetin e Lezhës tashmë do të ketë një zyrë avokatie falas. Kjo zyrë e ndihmës juridike për individët në nevojë, është mundësuar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Të gjithë personat që nuk kanë mundësi të paguajnë një proces gjyqësor, apo të paguajnë një avokat për probleme ligjore, do të marrin shërbim pranë kësaj zyre. Iniciativa e marrë nga gjykata e rrethit të Lezhës, vjen në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit për më shumë akses në drejtësi nga gratë dhe burrat shqipëtare, të nënshkruar nga ministri i Drejtësisë dhe mbështetur nga UNDP. Kryetarja e gjykatës së rrethit Lezhë, Ornela Naçellari theksoi ndër të tjera që nga ky shërbim do të përfitojnë grupet më vulnerabel për të bërë kështu edhe një barazi përpara ligjit për ata që nuk mund të paguajnë një avokat. Ajo u ndal edhe në rastet e dhunës në familje si në një ndër shqetësimet më të mëdha të shoqërisë tonë. Kryetarja e gjykatës u shpreh se me krijimin e kësaj zyre avokatie falas, akses do të jetë më i madh, mbrojtja dhe përfaqësimi do të jetë më efektiv dhe më afër. Kategoria e personave që kanë mundësi dhe që do të përfitojnë nga shërbimet ligjore falas, është e gjerë dhe përfshin pikërisht ato kategori për të cilat shoqëria ka më shumë shqetësim për të siguruar barazinë dhe aksesin në drejtësi. Bashkia Lezhë, si përfituese direkte, përmes nënkryetares Znj. Alfrida Marku, tha që hapja e kësaj zyre ka qënë një do-

mosdoshmëri për shtresat në nevojë. Nënkryetarja, në fjalën e saj, theksoi se një grua që e shikon veten objekt të një procesi gjyqësor nga gjykata apo prokuroria me një urdhër mbrojtjeje, patjetër që është shumë e disavantazhuar për t'u përfaqësuar në një proces gjyqësor të mëvonshëm që mund të jetë për zgjidhjen e martesës apo për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, pasi ajo e ka të pamundur të sigurojë apo të garantojë një mbrojtje ligjore nëpërmjet një avokati për shkak të problemeve ekonomike. Kjo zyrë synon rritjen e aksesit në drejtësi dhe garantimin e barazisë përpara ligjit për personat në kushte të vështira ekonomike si: gratë që jetojnë në zona rurale, gratë që janë kryefamiljare, viktimat e dhunës në familje, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, familjet në nevojë dhe minoritetet.

**Cfarë kuptojmë me Ndhimë Juridike**

Me Ndhimë Juridike kuptojmë ofrimin e shërbimit ligjor falas për individët në pamundësi financiare për të zgjidhur dhe realizuar të drejtat e tyre.

**Cilat janë format e Ndhimës Juridike që do të ofrohen nga ky projekt?**

**1. Ndhimë Juridike parësore përfshin:**

- Informacionin për sistemin ligjor dhe aktet normative në fuqi;
- Për të drejtat e detyrimit e subjekteve të ligjit;
- Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit në proceset gjyqësore, administrative etj.
- Për hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.
- Shërbim klinik dhe Law Line për klientët që mbasi këshillohen dhe përgatiten me dokumentat përkatëse ligjore, mund të vet-përfaqësohen në administratën publike apo gjykatë.
- Shërbim Ligjor Falas përmes internetit

Cdo qytetar mund të marrë informacion juridik dhe modele të gatshme (padish etj), për çështje të ndryshme, nëpërmjet portalit të TLAS.

**2. Ndhimë Juridike dytësore përfshin:**

- Këshillimin, përfaqësimin në proceset gjyqësore, civile dhe administrative;
- Çështjet që do të trajtohen me prioritet për përfaqësimin në gjykatë do t'i perkasin kryesisht familjeve ekstremisht të varfëra:
- Çështjet familjare.
- Çështjet e regjistrimit civil.
- Çështjet që lidhen me të drejtat ekonomike dhe sociale.

**3. Ndhimë Juridike nëpërmjet edukimit ligjor të publikut:**

- Përmes publikimeve; informacion ligjor dhe shpërndarje e fletëpalosjeve.
- Fushata televizive, në mediane shkruar dhe ate sociale; prezantim i projektit në televizionet lokale dhe median sociale te TLAS në facebook.
- Aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese në komunitet nga grupi i Studentëve të Fakultetit Juridik;
- Aktivitetet Street Law.

**Ky projekt ka për fokus kryesor dhënien e ndihmës juridike parësore. Në raste të caktuara prioritare, mund të ofrohet edhe ndihmë dytësore.**

**Cilat persona do të përfitojnë Ndhimë Juridike?**

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët kanë nevojë për Ndhimë Juridike në çështjet civile ose administrative dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar. Në këtë rast, personi duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to, si:

- Të miturit dhe jetimët.
- Gratë e dhunuara dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Minoritetet etnike, seksuale.
- Të moshuarit, etj.

**Ku do të kontaktojmë Avokatin e Ndhimës Juridike?**


Zyra e ndihmës juridike ndodhet në gjykatë e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, në katin e parë.

**TLAS PORTAL** portal.tlas.org

# Plazhi i Tales, një destinacion i ri në Lezhë

Ky plazh arriti të jetë një destinacion i parapëlqyer gjatë këtij sezoni turistik veror. Pastrimi në kohë, ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore që të dërgon drejt bregdetit dhe masat e marra nga Njësia Administrative dhanë efektin e tyre. Gjatë gjithë sezonit, në zonë konstatohet punonjës të angazhuar për të mirëmbajtur plazhin si dhe për të mundësuar sa më shpejt largimin e mbeturinave. Më shumë se 3 km vijë bregdetare ju nënshtrua pastrimit rishtas, ndërsa pjesa tjetër u pastrua nga privatët që kishin marrë hapësira publike për shfrytëzim. Ata që zgjedhën Tales për të kaluar fundjavën apo pushimet e tyre në këtë bregdet, gjetën një ambient optimal. I vetmi shqetësim mbeti mospajtimi i Shërbimit të Urgjencës, një problematikë që nuk mori vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë. Bregdeti i Tales pati shtim të ndjeshëm të vizitorëve dhe turistëve gjatë sezonit veror që sapo është mbyllur. Shërbimet e shtuara dhe gatishmëria ishin suksesi i kësaj vere, ndërsa pastërtia nuk ishte aspak çështje problematike. Dhjetë vite më parë askush nuk fliste për bregdetin e Tales në Lezhë. Zona frekuentohej vetëm në një pjesë të vogël nga vendasit edhe pse është një plazh me hapësira të mëdha publike dhe me një natyrë të mrekullueshme. Por, sot gjithçka ka ndryshuar. Bregdeti i Tales është plazhi me i afërt me Kosovën. Një tabelë në superstradë u thotë "Mirësevini" pushuesve që ndoshta drejtohen për në Shëngjin a Velipojë, e që ende nuk e dinë se çfarë humbin në Tale. Para viteve 90 plazhi i Tales ishte një zonë ushtarake ku nuk lejohej të hynin qytetarët e zakonshëm. Aktualisht, asgjë nuk ka të krahasuar me kohën para viteve 90. Situata sot ka ndryshuar ndjeshëm. Numri i pushuesve rritet vit pas viti, kjo sepse Talja është një

plazh familjar që ka vend për të gjithë. Por çfarë e bën të veçantë këtë zonë që thuajse dyfishon pushuesit vit pas viti? Natyra i ka dhënë bukurinë, por ajo që vihet re në Tale, është se pushuesit ndjehen në privatësi të plotë, ndërsa shijojnë qetësinë, rërën dhe detin. Hotelaria mbetet një problem pasi nuk përmbush dot kërkesën e lartë për akomodim. Të pushosh në Tale tashmë duhet të prenotosh, pasi nuk mund t'ia lësh më rastësisë. Nëse nivesh për pushime duke menduar se do të gjesh vend, mund të kesh surpriza. Bizneset kanë nisur të përshtaten me fluksin e pushuesve, duke përmbushur pjesën e tyre që Talja të krijojë fizionominë e një plazhi që ia vlen të vizitohet. Baret, restorantet dhe shtëpitë akomoduese e kanë ndryshuar këtë zonë. Kuzhina në Tale ka pjatat e saj të veçanta. Prodhimet e detit janë të gjitha të freskëta që sillen nga peshkatarët e zonës. Pavarësisht cilësisë, çmimet janë shumë të arsyeshme. Talja duhet vizituar qoftë edhe për të shuar kuriozitetin nga një plazh që dikur ishte i ndaluar. Edhe pse është një zone bregdetare, vetëm 100 m larg bregut, ka burime me ujë të pishëm. Administratori i Njësies Administrative të Shënkollit ku bën pjesë dhe Talja, Z. Albert Rrusti, i jep një përkufizim shumë modest Tales: "Mirësevini në Tale, në bregdetin që të josh sa më shumë që ta njohësh".





# Fillon në Lezhë viti i ri mësimor 2017-2018

Në 35 shkollat e Lezhës filloi viti i ri mësimor 2017-2018. Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Arsimit, procesi mësimor filloi normalisht dhe pa probleme, si në shkollat e arsimit fillor, 9-vjeçar, atij të mesëm dhe profesional. Në shkollat e Lezhës do vijojnë mësimet këtë vit të ri shkollor afërsisht 13.500 nxënës, ku 750 prej tyre nisin betejën e dijes, duke u ulur në bankat e klasës së parë. Me masat e marra nga Bashkia, objektet shkollore me gjithë rrjetin e tyre infrastrukturor, në këtë fillim viti të ri përformuan kushte normale mësimi në çdo klasë, ku nxënësit e të gjitha niveleve janë pajisur me tekstet mësimore. Dhjetë godina shkollore i janë nënshtruar procesit të rikonstruksionit dhe plotësojnë të gjitha standartet bashkëkohore për një proces mësimor normal. Në ceremoninë e fillim-vitit të ri mësimor, organizuar në gjimnazin "Hydajet Lezha", Zv.Kryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Dedgjonaj-Marku, duke përshëndetur në emër të Kryetarit Fran Frrokaj, ju uroi nxënësve e mësuesve të Lezhës një vit sa më të mbarë shkollor. Ajo vlerësoi punën e bërë në objektet shkollore

dhe premtoi një bashkëpunim të dobishëm me institucionet arsimore me synimin për të përmirësuar sa më shumë kushtet dhe cilësinë e mësimdhënies në shkollat më skajore të Lezhës. Zv.Kryetarja, Dedgjonaj-Marku, theksoi se Bashkia me politikat e saj arsimore do bëjë të pamundurën për të ndikuar në rritjen e përvitshme të cilësisë së procesit mësimor. Sa më cilësore dhe të qëndrueshme të jenë dijet që marrin nxënësit në shkolla, aq më të imunizuar do të jenë ata nga droga, dhe aq më të sigurtë do të jenë për të ardhmen e tyre. Fjalën e tyre përshëndetëse në këtë ceremoni, e dhanë drejtoresha e këtij gjimnazi Yllka Çuko dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Bardhok Pulaj të cilët duke uruar nxënësit e mësuesit për një vit sa më të suksesshëm mësimor, vunë theksin tek emri i mirë që ka fituar ndër vite gjimnazi "Hydajet Lezha" dhe tek rëndësia që ka sot shkolla dhe dija në përmbushjen e misionit të formimit arsimor e kulturor të shoqërisë sonë. Në ditën e parë të fillim vitit të ri shkollor, procesi mësimor vijoi normalisht në të gjitha shkollat e Lezhës.



## Arsimi profesional në Lezhë shënon një rritje cilësore

Shkolla e mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë për vitin shkollor 2017- 2018 ka rritur konsiderueshëm numrin e nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të. Rritja ka qënë sasiore dhe cilësore. Nota mesatare e të gjithë nxënësve të regjistruar për herë të parë është 7.5. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë më parë. Nëqoftëse vitin e kaluar nga numri total i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të ishin vetëm 24% vajza, këtë vit shkollor kjo shifër është 30%. Këtë vit shkolla ofron drejtimet e mëposhtme: Hoteleri-turizëm me 100 të regjistruar. TIK ( teknologji informacioni dhe komunikimi) 60 nxënës të regjistruar, Ekonomi- biznes me 42 nxënës të regjistruar dhe drejtimi i ri i çelur këtë vit shkollor, Shërbime Sociale dhe Shëndetësore me 21 nxënës të regjistruar, 90% e tyre vajza. Rritja e sasisë dhe cilësisë nuk është aspak rastësore, por ka ardhur falë punës me shumë përkushtim të stafit dhe drejtuesve të shkollës, mbështetjes që shteti po i jep këtij arsimit, ndihmës së madhe që qeveria e Zvicres, nëpërmjet projektit Aftësi për Punë S4J po i jep shkollës tonë, ndërgjegjësim-it të prindërve për rëndësinë që ka arsimi profesional për punësimin e fëmijëve të tyre dhe bashkëpunimit me bizneset më të njohura të zonës , për zhvillimin e praktikës profesionale të nxënësve pranë tyre...Arrijtet e shkollës kanë ardhur në rritje prej disa vitesh, duke fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare vit pas viti nxënësit tanë.

Gatë vitit shkollor 2016- 2017 një nxënëse në klasën e 10-të të shkollës sonë u kthye me medalje nga Kroacia ndërmjet nxënësve të 22 vendeve europiane. Në konkursin tre ditor të zhvilluar në Tiranë ndërmjet 36 shkollave shqipëtare të arsimit profesional, nxënësit tanë morën 2 vende të para. Në panairin e zhvilluar në fund të pranverës në Prizren, për firmat ushtrimore në

drejtimin ekonomik, ndërmjet 28 shkollave profesionale, shkolla jonë u shpërblye me çmimin e parë.

Në vitin e fundit projekti Aftësi për Punë ka ngritur në shkollë Qendrën e Karrierës, 2 laboratorë informatike bashkëkohore, 3 klasa të mësimit të kombinuar, ka siguruar internet në të gjithë shkollën, ka sjellë laptop për të gjithë mësuesit dhe për tre klasat e mësimit ndryshe. Ata po trajnojnë të gjithë stafin, për metodat e reja të mësimdhënies, për këshillim karriere, për gjurmimin etj. Po trajnojnë të gjithë stafin mbi teknologjinë dhe për përdorimin e regjistrave elektronikë.

Qëllimi i shkollës, i qeverisë, por edhe i projektit është lidhja e teorisë me praktikën, me qëllim aftësimin 100% të nxënësve në profesionin që kanë zgjedhur deri në përfundim të shkollës dhe punësimin e tyre. Të gjitha këto sa thame më lart do të ishin të pamundura, nëse nuk do të ishte edhe përkushtimi maksimal i stafit shumë të mirë të shkollës. Për vitin e ardhshëm shkollor duhet të rriten kapacitetet fizike të shkollës, sepse ecuria në rritje e nxënësve të regjistruar ka bërë që të ketë edhe mungesë të ambjenteve. Përkushtimi dhe puna e stafit do të njohë vetëm rritje në të mirë të brezit të ri, të familjeve të tyre dhe të gjithë ekonomisë kombëtare.







Bashkia Lezhë,  
Lagjia Skënderbeg,  
Sheshi "Gjergj Kastrioti",  
4501, Lezhë,  
[info@lezha.gov.al](mailto:info@lezha.gov.al)  
[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)